

OBJEKTIVAT VJETORE 2026

Sektori i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse

Sektori ushtron kompetenca teknike dhe administrative në përputhje me legjislacionin në fuqi, aktet nënligjore, urdhrat dhe udhëzimet përkatëse.

Objektivi 1: Menaxhimi strategjik dhe ligjor i fondeve buxhetore dhe jobuxhetore

Përshkrimi:
Të sigurohet planifikimi, administrimi dhe kontrolli i fondeve financiare në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe objektivat strategjike të IIPP-së.

Indikatorë matës:
- Realizimi i buxhetit vjetor mbi 95%.
- 0 raste shkeljesh të konstatuara nga auditimet e brendshme dhe të jashtme.
- Miratimi i Projekt-Buxhetit (PBA) brenda afateve ligjore.

Objektivi 2: Kontrolli dhe monitorimi i disiplinës financiare dhe kontabël

Përshkrimi:
Të garantohet respektimi i standardeve financiare dhe kontabël në të gjitha transaksionet e institucionit.

Indikatorë matës:
- Kryerja e analizave financiare tremujore (4 analiza/vit).
- 100% e transaksioneve të regjistruara sipas procedurave ligjore.
- Identifikimi dhe adresimi i çdo devijimi financiar brenda afatit 30-ditor.

Objektivi 3: Administrimi dhe mbikëqyrja e burimeve njerëzore

Përshkrimi:
Të sigurohet zbatimi korrekt i legjislacionit për burimet njerëzore dhe përditësimi i dokumentacionit të personelit.

Indikatorë matës:
- 100% e dosjeve personale të përditësuara.
- 0 ankesa administrative për pasaktësi në pagë, vjetëri ose dokumentacion.
- Plani vjetor i pushimeve i miratuar dhe i zbatuar në tërësi.

Objektivi 4: Forcimi i bashkëpunimit institucional dhe raportimit zyrtar

Përshkrimi:
Të rritet bashkëpunimi me Ministrinë e linjës, Thesarin dhe institucionet financiare për garantimin e një menaxhimi eficient të fondeve.

Indikatorë matës:
- 100% e raporteve zyrtare të dërguara brenda afateve ligjore.
- Likuidimi i faturave mbi 95% brenda afateve ligjore.
- 0 kthime dosjesh nga institucionet mbikëqyrëse për mangësi procedurale.

Objektivi 5: Transparenca dhe korrektësia në ndihmat ekonomike dhe transfertat financiare

Përshkrimi:
Të garantohet transparencë dhe ligjshmëri në procedurat e dhënies së ndihmave ekonomike dhe transfertave financiare.

Indikatorë matës:
- 100% e dosjeve të ndihmave ekonomike të verifikuara sipas kritereve ligjore.
- 0 ankesa të argumentuara për mungesë transparence.
- Evidencat financiare të publikuara dhe të dokumentuara.

Objektivi 6: Organizimi dhe mbarëvajtja e shërbimeve mbështetëse

Përshkrimi:
Të sigurohet funksionimi normal i shërbimeve administrative, logjistike dhe teknike të institucionit.

Indikatorë matës:
- 100% funksionalitet i shërbimeve mbështetëse.
- Rishikimi i të paktën 1 rregulloreje të brendshme gjatë vitit 2026.
- Ulje e vonesave administrative krahasuar me vitin paraardhës.

Sektori i Ligjshmërisë dhe Statusit

I. Objektiva në Fushën e Koordinimit dhe Zbatimit të Legjislacionit

1. Të realizojë koordinimin e veprimtarisë si njësi e specializuar për çështjet ligjore, duke garantuar zbatimin praktik të ligjeve, vendimeve dhe urdhëresave të Këshillit të Ministrave.
2. Të sigurojë kontrollin e ligjshmërisë dhe të siglojë urdhrat, udhëzimet dhe shkresat e nxjerra nga institucioni, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

3. Të garantojë bazueshmërinë ligjore të projekteve dhe programeve rehabilituese e integruese në dobi të ish të përndjekurve politikë.
4. Të hartojë dhe përmirësojë akte administrative, kontrata dhe dokumente të tjera ligjore të nevojshme për veprimtarinë institucionale.

II. Objektiva në Fushën e Statusit dhe Dokumentacionit

1. Të pajisë personat e interesuar me **Vërtetim për Dhënie Statusi**, në përputhje me vendimet e Komisionit Shtetëror Trepalësh dhe legjislacionin në fuqi.
2. Të administrojë, sistemojë dhe kompjuterizojë të dhënat statistikore mbi ish të përndjekurit politikë sipas kategorive përkatëse.
3. Të bashkëpunojë me Arkivën për nxjerrjen e dokumentacionit sipas kërkesave të paraqitura nga ish të dënuarit, të përndjekurit politikë apo trashëgimtarët e tyre.
4. Të hartojë shkresa për dhënie dhe marrje informacioni lidhur me çështjet e statusit dhe dokumentacionit përkatës.

III. Objektiva në Shërbim të Qytetarëve dhe Mbështetjes Ligjore

1. Të realizojë pritjen dhe sqarimin në rrugë ligjore të ish të përndjekurve politikë për problematikat e paraqitura.
2. Të ofrojë konsulencë ligjore dhe asistencë administrative për çështje që lidhen me statusin, dëmshpërblimin, pensionet dhe përfitime të tjera ligjore.
3. Të mbledhë, shqyrtojë dhe trajtojë kërkesat e paraqitura nga qytetarët brenda kompetencave të institucionit.
4. Të sigurojë komunikim dhe bashkëpunim të vazhdueshëm ndërmjet sektorëve të institucionit për zgjidhjen efektive të problematikave të ndryshme.

IV. Objektiva në Bashkëpunimin Ndërinstitucional

1. Të bashkëpunojë me Ministrinë e Drejtësisë për ndjekjen e çështjeve që lidhen me gjendjen e dosjeve të ish të dënuarve dhe të përndjekurve politikë.
2. Të bashkëpunojë me Drejtorinë e Pagesave dhe Dëmshpërblimit pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për çështjet që lidhen me këstet e dëmshpërblimit.
3. Të bashkëpunojë me Instituti i Sigurimeve Shoqërore për përllogaritjen e pensioneve sipas viteve të dënimit ose internimit.
4. Të përfaqësojë institucionin, me autorizim të titullarit, në marrëdhëniet me pushtetin vendor, pushtetin qendror dhe palë të treta për zgjidhjen e çështjeve ligjore.

V. Objektiva në Përfaqësimin dhe Ndjekjen e Çështjeve Ligjore

1. Të përfaqësojë institucionin në procese gjyqësore si palë paditëse, palë e paditur ose person i tretë, sipas autorizimit përkatës.
2. Të ndjekë në rrugë administrative dhe gjyqësore çështjet që lidhen me veprimtarinë e institucionit.
3. Të sigurojë përmbushjen me korrektësi dhe brenda afateve të të gjitha detyrave të ngarkuara nga titullari i institucionit.

VI. Objektiv i Përgjithshëm

Të realizojë me sukses, profesionalizëm dhe brenda afateve ligjore të gjitha detyrat funksionale të sektorit, duke garantuar ligjshmëri, transparencë, efikasitet dhe shërbim cilësor në mbështetje të ish të përndjekurve politikë.

Sektori i Çështjeve Sociale dhe Koordinimit të Projekteve

1. Trajtimi efektiv i kërkesave dhe shkresave zyrtare të ish të përndjekurve politikë

Objektiv:

Të trajtohen me efikasitet kërkesat e ish të përndjekurve politikë për punësim, arsimim, kualifikim, mbrojtje në punë dhe rehabilitim. Të sigurohet shqyrtimi dhe trajtimi brenda afateve ligjore i të gjitha kërkesave për punësim, arsimim, kualifikim profesional, mbrojtje në punë dhe rehabilitim kulturor e shëndetësor, duke hartuar shkresat përkatëse dhe duke propozuar zgjidhje konkrete për çdo rast.

Tregues matës:

- 100% e kërkesave të shqyrtohen brenda 10–15 ditëve pune.
- Të hartohen dhe dërgohen shkresat përkatëse brenda afateve ligjore.

Afati: Monitorim mujor, raportim gjashtëmujor.

2. Evidentimi, analiza dhe adresimi i problematikave

Objektiv:

Të krijohet një pasqyrë e përditësuar e gjendjes sociale dhe ekonomike të përfituesve. Të evidentohet dhe dokumentohet në mënyrë periodike gjendja sociale dhe ekonomike e ish të përndjekurve politikë, si dhe të hartohen rekomandime konkrete për zgjidhjen e problematikave në përputhje me legjislacionin në fuqi. Krijimi i formateve standart, plotësimi i dokumentacionit të nevojshëm.

Tregues matës:

- Përditësimi i databazës së të dhënave të përftuesve.
- Hartimi i raporteve analitike (vjetore).
- Propozimi i rekomandimeve konkrete për përmirësim politikash.

Afati: Analiz vjetore.

3. Integrimi social dhe bashkëpunimi me OJF

Objektiv:

Të forcohet integrimi social i ish të përndjekurve politikë dhe familjarëve të tyre. Të hartohet dhe zbatohet një plan veprimi vjetor për integrimin social të ish të përndjekurve dhe familjarëve të tyre, bazuar në analizën e nevojave dhe prioriteteve të identifikuara. Të organizohen aktivitete dhe iniciativa në bashkëpunim me organizata jofitimprurëse dhe institucione të tjera, me qëllim rehabilitimin, promovimin e vlerave morale dhe rritjen e përfshirjes sociale të kësaj shtrese.

Tregues matës:

- Organizimi i aktiviteteve rehabilituese/ndërgjegjësuese gjatë vitit.
- Bashkëpunim me organizata jofitimprurëse.
- Monitorimi dhe raportimi i zbatimit të projekteve 1 herë në 6 muaj.

Afati: Gjatë gjithë vitit.

4. Mbështetja e të drejtës për arsimim

Objektiv:

Të sigurohet ndjekja dhe zbatimi korrekt i të drejtave të studimit për fëmijët e ish të përndjekurve politikë. Krijimi i formateve standart, regjistrimi dhe përcjellja në fakultetet respektive.

Tregues matës:

- Trajtimi 100% i kërkesave për tarifa studimi brenda afateve.
- Ndjekje e plotë e procedurave për çdo rast të referuar.
- Raport vjetor mbi ecurinë e përfitimeve në arsim.

Afati: Sipas kalendarit akademik.

5. Koordinimi për dëmshpërblime dhe asistencë dokumentacioni

Objektiv:

Të lehtësohet procesi i aplikimit për dëmshpërblim dhe pagesa.

Tregues matës:

- Asistencë për 100% të aplikantëve që paraqiten pranë institucionit.
- Reduktim i gabimeve në dokumentacion.
- Koordinim periodik (minimumi 4 takime në vit) me institucionet përkatëse.

Afati: Monitorim gjashtëmujor.

6. Përmirësimi i cilësisë së shërbimit

Objektiv:

Të rritet transparenca dhe efikasiteti në ofrimin e shërbimeve. Të sigurohet kthimi i përgjigjeve brenda afateve të përcaktuara ligjore dhe të përmirësohet komunikimi institucional me përfituesit, duke rritur nivelin e transparencës dhe besueshmërisë.

Tregues matës:

- 100% e përgjigjeve të jepen brenda afateve ligjore.
- Evidentimi dhe trajtimi i çdo ankese brenda 5 ditëve pune.
- Hartimi i një raporti vjetor mbi performancën dhe përmirësimet e realizuara.

Afati: Monitorim i vazhdueshëm, raportim në fund të vitit.

Sektori për Gjetjen e të Zhdukurve nga Krimet e Komunizmit

Monitorimi dhe Ndjekja e Procesit të Kërkimit dhe Zhvarrosjes

1. Të ndjekë, monitorojë dhe verifikojë procesin e kërkimit dhe zhvarrosjes së viktimave të ish të përndjekurve politikë, në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse.
2. Të koordinojë veprimet me organet ligjzbatuese qendrore dhe vendore, si dhe me institucionet që disponojnë arkiva, për identifikimin e personave të zhdukur gjatë periudhës 29.11.1944 – 01.10.1991.
3. Të bashkëpunojë me
   Ministria e Brendshme,
   Prokuroria e Përgjithshme,
   Instituti i Mjekësisë Ligjore,
   si dhe me prokuroritë në rrethe, për vijimin e procedurave të gjetjes dhe identifikimit të eshtrave të viktimave.

Mbledhja e Dëshmive dhe Dokumentacionit

1. Të mbledhë dëshmi reale nga të mbijetuarit e diktaturës komuniste për:
   - ekzekutimet me ose pa gjyq,
   - vdekjet në burgje,
   - vrasjet në hetuesi apo institucione psikiatrike,
   - groposjet në varre kolektive,
   - vrasjet në kufi gjatë tentativave për arratisje.
2. Të akumulojë dokumentacion arkivor, dëshmi audiovizive dhe materiale autentike nga të mbijetuarit, në funksion të dokumentimit të plotë të krimeve të regjimit komunist.
3. Të krijojë dhe përditësojë një database të integruar dhe sa më të plotë mbi personat e zhdukur, të ekzekutuar dhe të vdekur në burgje, kampe internimi dhe qendra torturash, në bashkëpunim me institucionet qendrore dhe vendore.

Ndërgjegjësimi dhe Përfshirja e Familjarëve

1. Të vijojë ndërgjegjësimin publik për plotësimin e dokumentacionit të nevojshëm nga familjarët, me qëllim përfshirjen në procesin e kërkimit dhe identifikimit të eshtrave të viktimave të krimeve të komunizmit.
2. Të bashkëpunojë me shoqatat përfaqësuese të ish të përndjekurve politikë për koordinimin e punës në funksion të hartëzimit të varreve masive, bazuar në dokumentacion dhe dëshmi të verifikuara.

Bashkëpunimi Kombëtar dhe Ndërkombëtar

1. Të koordinojë dhe bashkëpunojë me institucione të huaja të specializuara për marrjen e asistencës teknike dhe ligjore në procesin e zhvarrimit, ekspertizës mjeko-ligjore dhe identifikimit të kufomave.
2. Të forcojë bashkëpunimin ndërinstitucional për garantimin e standardeve profesionale dhe ligjore në çdo fazë të procesit.

Objektivi Strategjik

Të kontribuojë në zbardhjen e së vërtetës historike, rivendosjen e dinjitetit të viktimave dhe të familjarëve të tyre, si dhe në forcimin e kujtesës kolektive dhe drejtësisë tranzicionale në Shqipëri.